



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 shtator 2013  
Nr.ref.:RK470/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KO118/13**

Parashtrues

**Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Albana Fetoshi, Visar Ymeri, Albulena Haxhiu, Albin Kurti, Liburn Aliu, Albana Gashi, Afrim Kasolli, Glauk Konjufca, Afrim Hoti, Rexhep Selimi, Emin Gërbeshi, Agim Kuleta dhe Muhamet Mustafa, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Parashtruesit kanë autorizuar znj. Albana Fetoshi që t'i përfaqësojë ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

## **Ligji i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Ligjin Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 (në tekstin e mëtejme: Ligji i ndryshuar për Buxhet), i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) më 25 korrik 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Ligjit të ndryshuar për Buxhetin, i cili është miratuar nga Kuvendi me Vendimin nr. 04/L-671, të 25 korrikut 2013.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 42 dhe neni 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 1 gusht 2013, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
6. Më 1 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO118/13, caktoi Gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO118/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović (anëtarë).
7. Më 2 gusht 2013, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë nga parashtruesit dhe kërkoi nga ata që të dorëzojnë komentet e tyre, si dhe çfarëdo dokumentesh që ata i konsiderojnë të domosdoshme përkitazi me kërkesën.
8. Presidentja e Republikës së Kosovës u informua të njëjtën ditë për kërkesën e dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit.
9. Më 7 gusht 2013, nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gjykata mori këto dokumente:
  - a. Raportin final të Komisionit për Buxhet dhe Financa, të 19 korrikut 2013, që ka të bëjë me Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin;
  - b. Transkriptin e Seancës plenare të Kuvendit, të mbajtur më 25 korrik 2013;

- c. Procesverbalin e Seancës plenare të Kuvendit, të mbajtur më 25 korrik 2013;
  - d. Listën e votimit elektronik;
  - e. Vendimin e Kuvendit, të 25 korrikut 2013, për miratimin e Ligjit të ndryshuar për Buxhetin (Vendimi nr. 04-V-671); dhe
  - f. Kopjen e Ligjit të ndryshuar për Buxhetin.
10. Më 29 gusht 2013, Qeveria dorëzoi në Gjykatë komentet e saj përkitazi me Rastin KO118/13.
  11. Më 30 gusht 2013, parashtruesit u informuan për komentet e Qeverisë.
  12. Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e përgatitur nga gjyqtarja Snezhana Botusharova, Gjyqtare raportuese, dhe i paraqiti rekomandim Gjykatës në përbërje të plotë.
  13. Më 2 shtator 2013, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për kërkesën.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 17 qershor 2013, Qeveria vendosi të miratojë Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin dhe udhëzoi Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që të paraqesë Projektligjin në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe për miratim.
15. Më 18 qershor 2013, Kryetari i Kuvendit ia dërgoi të gjithë deputetëve të Kuvendit Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin. Për më tepër, Komisioni për Buxhet dhe Financa u caktua të shqyrtojë Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin dhe të paraqesë në Kuvend një raport me rekomandime.
16. Më 26 qershor 2013, Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtoi Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin dhe i rekomandoi Kuvendit që ta miratojë këtë projektligj në leximin e parë.
17. Më 11 korrik 2013, në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 58 e me nenin 84 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi, me Vendimin nr. 04-V-646, në leximin e parë, me 49 vota për, 35 kundër dhe asnjë abstenim, miratoi në parim Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin.
18. Më 19 korrik 2013, Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrtoi Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin për të dytën herë dhe i rekomandoi Kuvendit që, në leximin e dytë, ta miratojë këtë projektligj.
19. Më 25 korrik 2013, në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 58 e me nenin 84 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi, me Vendimin nr. 04-V-671, në leximin e dytë, me 51 vota për, 31 kundër dhe 2 abstenime, miratoi Projektligjin e ndryshuar për Buxhetin.

20. Më 1 gusht 2013, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 42 e të nenit 43 të Ligjit, parashtruesit dorëzuan në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të ndryshuar për Buxhetin , duke kontestuar përmbajtjen e tij.

### **Argumentet e paraqitura nga parashtruesit**

21. Parashtruesit konsiderojnë se shkel Kushtetutën neni 2 i Ligjit të ndryshuar për Buxhetin, i cili thotë: *“Të gjitha paratë publike të mbledhura prej mallrave të importuara nga bizneset e regjistruara në Veri të Mitrovicës, Zubin Potok, Leposaviq apo Zveçan, të cilat janë të destinuara për konsum në këto komuna në momentin e hyrjes në Kosovë përmes pikave doganore në Jarinjë (pika 1) ose Bërnjakë (pika 3) duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht në SIMFK dhe të ndahen për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit që do të krijohet nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë në një Banke Komerciale”.*
22. Ata pretendojnë se neni i lartpërmendur shkel nenin 119.4 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që thotë: *“Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik”.*
23. Sipas këndvështrimit të parashtruesve, *“[...] termi promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët dhe shpreh frymën e barazisë dhe jodiskriminimit të të gjithë qytetarëve para ligjit dhe angazhimit të organeve shtetërore pa ndonjë dallim për cilëndo përkatësi të qytetarëve. Pra, promovimi i mirëqenies për çdo qytetar shpreh angazhimin e barabartë pa asnjë dallim nga ana e organeve shtetërore, në aspektin e marrëdhënieve ekonomike, që përfshin këtu të gjitha aspektet ekonomike, nisur nga faktorët makroekonomikë e deri në krijimin e kushteve në mikroekonomi”.*
24. Parashtruesit, më tej, i referohen nenit 3, paragrafi 1 e paragrafi 2, të Kushtetutës, ku thuhet:

*“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”.*

*“2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”.*

Sipas mendimit të tyre, *“shteti, duke garantuar barazinë në qasjen publike, në këtë rast të promovimit të mirëqenies së qytetarëve, duhet të kujdeset që kjo qasje të mos cenojë të drejtat individuale dhe kolektive të cilitdo komunitet brenda territorit të Kosovës”.* Në këtë drejtim, sipas parashtruesve, *“në këtë rast konkret, është e pamundur që Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit të jetë në*

*përputhje me parimin e barazisë që është shprehur me dispozita të këtij paragrafi kushtetues”.*

25. Parashtruesit pretendojnë gjithashtu se neni 2 i Ligjit të ndryshuar për Buxhetin shkel nenin 120.1 [Financat Publike] të Kushtetutës. Neni 120.1 thotë: *“Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës”.*
26. Sipas këndvështrimit të parashtruesve, sipas këtij neni, ekziston një *“[...] detyrim kushtetues që shpenzimet dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohet në parimet e llogaridhënies”,* ku llogaridhënia përfshin *“[...] përgjegjësinë e organizatave buxhetore (konkretisht përfshin organet shtetërore të cilave u njihet kompetenca për menaxhimin e financave publike) që të gjitha veprimet e tyre t’i përshtatin sipas standardeve kushtetuese-ligjore mbi bazën e të cilave konceptohet përgjegjësia e këtyre organizatave buxhetore”* dhe *“[...] përgjegjësinë e organit që të raportojë mbi aktivitetet e saj financiare dhe këtë ta bëjë sipas rregullativës ligjore të bazuar në parimet kushtetuese, të cilat janë trajtuar më lart”.*
27. Në këtë drejtim, parashtruesit pohojnë se dispozitat e Ligjit të ndryshuar për Buxhetin çdo herë duhet të jenë në përputhje me normën që buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Nr. 03/L-048: *“Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keqzbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të parregullt paratë publike”.* (Shih, neni 17 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike). Prandaj, sipas parashtruesve, shfrytëzimi dhe alokimi i këtyre mjeteve publike mund të bëhet vetëm me një miratim paraprak, të përcaktuar me një akt të përgjithshëm të miratuar nga Kuvendi.
28. Parashtruesit më tej deklarojnë se, në asnjë mënyrë, nuk mund të përcaktohet një fond i veçantë për shkak të centralizimit të mjeteve financiare nga Buxheti i Kosovës në bazë të nenit 17.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, ku thuhet: *“Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF sipas paragrafit 2, të nenit 38 të këtij Ligji”.*
29. Prandaj, sipas mendimit të parashtruesve, të hyrat tatimore duhet të alokohen në llogaritë që janë pjesë e Llogarisë së Vetme të Thesarit, që përbëhet nga të gjitha llogaritë dhe nënlllogaritë që mbahen në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, në pajtim me nenin 18.1 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, ku thuhet: *“[...] Të gjitha llogaritë dhe nënlllogaritë e sipërcekura do të jenë pjesë e Llogarisë së Vetme të Thesarit. Të gjitha pagesat dhe shpenzimet e parave publike duhet të bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit”.* Kështu, sipas parashtruesve, themelimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit, në cilëndo bankë komerciale, është në kundërshtim me këtë dispozitë.
30. Parashtruesit konsiderojnë se *“Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nuk ka paraparë mundësinë e alokimit të mjeteve financiare pa projektim paraprak të një organizate buxhetore në përputhje me Ligjin për ndarje buxhetore, mjete të tilla nuk mund të*

regjistrohen në SIMFK (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) dhe pastaj të alokohen në një xhirrollogari, e aq më tepër që nuk është pjesë e LLVTH-së”.

31. Parashtruesit më tej vërejnë se “[...] dispozitat e paragrafit 9 të nenit 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike në lidhje me Përgatitjen dhe Rishqyrtimin e propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore, në paragrafin 9 nuk është paraparë mundësia ligjore për inicimin e rishqyrtimit buxhetor ku përfshihet themelimi i një Fondi dhe alokimin e mjeteve në një fond të veçantë”. Në këtë drejtim, ata i referohen nenit 20.9, ku thuhet:

“[...]

*20.9 Propozim Ligji për Ndarje Buxhetore i parashtron ndarjet buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore dhe përfshin:*

*a) në rast të ndarjeve buxhetore, klasifikimin e secilit shpenzim të këtyllë në pajtim me metodologjinë e aplikueshme të klasifikimit: duke përfshirë shpenzimet e përgjithshme faktike gjatë vitit të kaluar fiskal, si dhe vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme faktike për vitin aktual fiskal;*

*b) në rast se ndarja buxhetore bëhet për pagimin e një borxhi të lejuar në bazë të këtij ligji, shumën (nëse ka të tillë) të ndarë:*

*(i) për pagimin e interesit, ose ngarkesave të ngjashme me interesin në borxh;*

*(ii) për pagimin e shumës kryesore të borxhit;*

*(iii) për pagimin e dënimeve ose shumave të tjera që ngarkohen për pagesë të vonshme, nëse ka të tilla; dhe*

*(iv) për pagimin e çfarëdo shume në lidhje me borxhin, nëse ka të tillë;*

*c) në rast të shpenzimeve të paparashikuara, një ndarje të propozuar buxhetore që nuk tejkalon pesë për qind (5%) të shpenzimeve të përgjithshme.*

“[...]

32. Parashtruesit më tej pohojnë se, në nenin 2 të Ligjit të ndryshuar për Buxhetin, theksohet se themelimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit do të bëhet nga ana e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë. Ata pohojnë se Përfaqësuesi Special i BE-së nuk ka autorizim kushtetues për të krijuar një fond të tillë dhe se kjo do të jetë shkelje e nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] të Kushtetutës, sepse “dispozitat e këtij neni qartazi përcaktojnë parimet mbi të cilat konsolidohet forma e qeverisjes së pushtetit në sferën legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”. Ata theksojnë se “një kompetencë e tillë cenon atributin e pushtetit ekzekutiv, siç është përkufizuar në dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni, si dhe në dispozitën e nenit 92, paragrafi 2 dhe 3, në lidhje me nenin 93 pika (6) dhe (7) të Kushtetutës së Kosovës”, pasi “[...] themelimi i këtij fondi është cilësi ekzekutive e cila nuk mund të tjetërsohet nga pushteti

*ekzekutiv, dhe si e tillë është kategori kushtetuese sipas nenit 4, paragrafi 4, dhe nenit 92, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës”.*

### **Argumentet e paraqitura nga Qeveria**

33. Qeveria thekson se *“[...] themelimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit, i cili ka për qëllim zhvillimin e komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan [...] është në përputhje me nenin 58 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe një masë e tillë nuk mund të konsiderohet si diskriminim për pjesën tjetër të shoqërisë. Qëllimi i kësaj mase është pikërisht integrimi i këtij komuniteti në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të Republikës së Kosovës përmes rritjes së zhvillimit ekonomik të këtyre komunave që i përkasin pakicës serbe dhe promovimit të një barazie të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtareve të komuniteteve”.*
34. Për më tepër, Qeveria konsideron se *“[...] dispozitat e këtij ligji janë në përputhje të plotë me karakterin unitar të Republikës së Kosovës në aspektin e mbledhjes së të hyrave, pasi ato mbledhen në mënyrë të njëjtë në të gjitha pikat kufitare të Republikës së Kosovës, në përputhje me të njëjtin legjislacion në fuqi në tërë Republikën e Kosovës dhe dërgohen në Fondin e Kosovës”.*
35. Gjithashtu, Qeveria vëren se *“bazuar në konkluzionet e Grupit Punues për Dogana ndërmjet Serbisë dhe Kosovës të ndërmjetësuar nga BE, të datës 10-17 janar 2013, është paraparë edhe themelimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit [...]”, i cili “[...] është i mbikëqyrur nga një komision i përbërë nga Ministri i Financave, EUSR dhe një përfaqësues serb i Kosovës”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

36. Në përputhje me nenin 113.5 të Kushtetutës, detyrë e Gjykatës është të vlerësojë nëse përmbajtja e ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, siç pretendohet nga parashtruesit. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se ligji i kontestuar shkel nenet: 3.1 e 3.2, 4, 19.4, 92.2 e 92.3, 93.6 e 93.7, 119.4 dhe 120.1 të Kushtetutës dhe të dispozitave të ndryshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Nr. 03/L-048.
37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, kur një ligj ose një akt është në shqyrtim sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, procedura e vlerësimit do të jetë e natyrës pezulluese, ashtu që do të bllokohet shpallja e ligjit derisa Gjykata të marrë një vendim përfundimtar për rastin. Në pajtim me nenin 43 (2) të Ligjit, në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, *“ligji [...] i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”,* që do të thotë se Ligji i miratuar nuk duhet t’i kthehet Kuvendit por duhet t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet të cilat Gjykata i ka shpallur në Aktgjykimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën.
38. Sa i përket pretendimit të parashtruesve se ligji i kontestuar cenon dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Nr. 03/L-048, Gjykata përsërit pikëpamjen e vet se, në bazë të nenit 112 [Parimet e Përgjithshme] të

Kushtetutës, ajo është kompetente për të vlerësuar vetëm kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar, por jo ligjshmërinë e tij. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës, sipas nenit 112 të Kushtetutës, është jashtë juridiksionit të Gjykatës dhe, si e tillë, nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

39. Ndërsa, sipas pretendimeve të parashtruesve se ligji i kontestuar cenon paragrafin 1 e paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 4 të nenit 19 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafin 1 të nenit 120 [Financat Publike] të Kushtetutës, Gjykata i referohet paragrafit 1.3 të nenit 42 [Saktësimi i Kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, që parasheh se duhet të parashtrohen, *inter alia*, informatat në vijim: “*paraqitje e provave mbi të cilat mbështetet kontesti*”.
40. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit vetëm kanë argumentuar në abstrakt jokushtetutshmërinë e pretenduar të ligjit të kontestuar, por nuk kanë provuar në mënyrë bindëse se ligji i kontestuar do të shkelte secilin prej neneve të Kushtetutës, në të cilat thirren ata, dhe nuk kanë paraqitur prova në mbështetje të pretendimeve të tyre.
41. Ndërsa, sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 120 të Kushtetutës, që përcakton: “*Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës*”, parashtruesit kanë theksuar atë se çka duhet të përfshijë llogaridhënia në këtë rast dhe si mund të japë llogari një autoritet shtetëror për veprimet e veta pa ekzistuar obligimi për të vepruar në një mënyrë të caktuar.
42. Sa i përket kësaj ankese, Gjykata është e mendimit se parashtruesit as nuk kanë ndërtuar rast për një shkelje të të drejtave në të cilat thirren ata, as nuk kanë paraqitur prova *prima facie* për shkelje të tilla (Shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Kërkesa nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendimi përkitazi me pranueshmërinë, i 31 majit 2005, dhe shih Rastin Nr. KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri i 13 dhjetorit 2011).
43. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar, sipas rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, që përcakton: “*Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar*”.
44. Përfundimisht, parashtruesit pohojnë se krijimi i Fondit të Mirëbesimit për Zhvillim nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE-ja), siç përmendet në nenin 2 të ligjit të kontestuar, shkel nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], paragrafin 2 e paragrafin 3 të nenit 92 [Parimet e Përgjithshme], si dhe paragrafin 6 e paragrafin 7 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës. Sipas pikëpamjes së tyre, PSBE-ja nuk ka “autorizim kushtetues” sipas këtyre neneve që të krijojë një fond të tillë të veçantë, pasi që, në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese, kjo është një kompetencë e patjetërsueshme e pushtetit ekzekutiv.
45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 2 i ligjit të kontestuar përcakton: “*Të gjitha paratë publike të mbledhura prej mallrave të importuara nga bizneset e regjistruara në Veri të Mitrovicës, Zubin Potok, Leposaviq apo Zveçan, të cilat*



*janë të destinuara për konsum në këto komuna në momentin e hyrjes në Kosovë përmes pikave doganore në Jarinjë (pika 1) ose Bërnjakë (pika 3) duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht në SIMFK dhe të ndahen për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit që do të krijohet nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë në një bankë komerciale”.*

46. Sipas ankesës së parashtruesve, Gjykata vëren se neni i mësipërm nuk përcakton modalitetet përkitazi me themelimin e Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit nga PSBE-ja, e lëre më të mund të interpretohet si një delegim i qartë i kompetencave ekzekutive nga Qeveria te PSBE-ja. Prandaj, Gjykata konstaton që pretendimet e parashtruesve se janë shkelur dispozitat kushtetuese të përmendura më lart, nuk janë provuar në mënyrë të mjaftueshme, pasi ata nuk kanë paraqitur ndonjë provë bindëse që mbështet këto pretendime, siç kërkohet me nenin 42.1.3 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
47. Për më tepër, Gjykata vëren se Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë detyrime financiare me Marrëveshjen e Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Në pikën 12, të kësaj marrëveshjeje, është theksuar: *“Një plan zbatimi, i cili përfshin dhe afatin kohor, do të krijohet deri më 26 prill. Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të trajtohet dhe parimi i financimit transparent”*, përderisa në pikën 15 përcaktohet: *“Do të themelohet një komitet zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së”*. Për më tepër, plani i zbatimit, sipas pikës 6 [Dispozitat e Përgjithshme] të Kushtetutës, *inter alia*, përcakton se *“[...] metoda për të arritur parimet për financim transparent do të përcaktohet nga të dy palët në Komitetin e Zbatimit”*.
48. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në mënyrë të ngjashme me këtë situatë, një çështje ishte ngritur nga një grup deputetësh në Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë përkitazi me atë nëse Fondi i Përhershëm i Shpëtimit, të cilin e kishin themeluar kombet e Eurozonës (Mekanizmi i Stabilitetit Evropian) ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën gjermane. Kjo ishte pasojë e detyrimeve financiare të Republikës Federale të Gjermanisë, që dalin nga Traktati i Maastricht-it, ku *“[...] palët ranë dakord për një politikë të përbashkët monetare të Shteteve Anëtare, e cila kishte për qëllim që në faza të krijojë një bashkim monetar evropian dhe në fund të bartë politikën monetare në duart e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Në fazën e tretë të këtij procesi, euroja u prezantua si monedha e vetme”*.
49. Gjykata Kushtetuese gjermane theksoi se nuk mund të përcaktohet nëse vlera e garancive të caktuara tejkalon limitin e kapacitetit buxhetor deri në atë masë sa që autonomia e buxhetit praktikisht do të bëhej krejtësisht e paefektshme.
50. Prandaj, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë refuzoi si të pabazuara ankesat kushtetuese të grupit të deputetëve, të cilat ishin të drejtuara kundër instrumenteve juridike gjermane dhe evropiane dhe kundër masave të tjera për sa i përket ndihmës për Greqinë dhe pakos për shpëtimin e euros (Shih, Aktgjykimi 2 BvR 987/10, Aktgjykimi 2 BvR 1485/10 dhe Aktgjykimi 2 BvR 1099/10, të 12 shtatorit 2012).

51. Gjykata vëren se Kushtetuta parasheh që Qeveria, dhe vetëm ajo, mund ta përcaktojë buxhetin kombëtar. Në këtë drejtim, duke miratuar Ligjin Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit r. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, Kuvendi nuk ka cenuar në mënyrë të palejueshme me Kushtetutë të drejtën e vet për të miratuar buxhetin dhe për të kontrolluar zbatimin e tij.
52. Duke trajtuar ankesën e parashtruesve si tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1(c) të Rregullores së punës.
53. Megjithatë, Gjykata vëren që, në qoftë se në fazat e mëtutjeshme të zbatimit të këtij ligji paraqiten çështje kushtetuese, palët e autorizuara mund të parashtrorin çështje të tilla në këtë gjykatë.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores, më 2 shtator 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. TË SHPALLË që, në pajtim me nenin 43 të Ligjit, ky ligj i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;
- III. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- V. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani